

BULETIN BINJAKËZIMI

Buletin tremujor i publikuar nga Projekti i Binjakëzimit 'Mbështetje për Statistikat' në Kosovë - projekt i financuar nga programi i Binjakëzimit i Bashkimit Evropian për shtetet IPA

Rritja e përputhshmërisë me standardet e BE-së në fushën e statistikës

> Ky është buletini i katërt i Projektit të Binjakëzimit, financuar nga BE-ja, "Mbështetje për Statistikat" Kosovë (KS 12 IB ST 01).

Ky projekt i financuar nga BE-ja implementohet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në bashkëpunim me Statistikat e Danimarkës. Gjithashtu, janë të përfshirë ekspertë nga Finlanda, Lituanija, Irlanda Veriore dhe Italia.

Tashmë ka përfunduar viti i parë i implementimit të projektit. Çdo buletin i përgatitur në baza tremujore paraqet një vështrim të përgjithshëm mbi aktivitetet e realizuara gjatë atij tremujori, në këtë rast Shtator, Tetor dhe Nëntor të vitit 2014.

Informacione mbi projektin

Projekti i Binjakëzimit, i financuar nga BE-ja, zgjat 24 muaj, deri në dhjetor të vitit 2015, dhe ka një buxhet prej 1.5 milion EUR. Projektet e Binjakëzimit janë një iniciativë e Bashkimit Evropian, me qëllimin të ndihmojë vendet e reja anëtare, vendet kandidate dhe vendet fqinje, të fitojnë shkathtësitë dhe përvojat e nevojshme për përvetësimin, zbatimin dhe fuqizimin e legjislacionit të BE-së. Ky Projekt Binjakëzimi ka për qëllim të përkrahë ASK-në në prodhimin dhe diseminimin e statistikave sipas standardeve të BE-së.

> Projekti mbulon katër komponente:

Komponenti 1. Një sistem cilësie për statistikën. Ky komponent ka për qëllim të fuqizojë kapacitetin e përgjithshëm të ASK-së.

Komponenti 2. Llogaritë Kombëtare. Qëllimi do të jetë rritja e përputhshmërisë me standardet aktuale të BE-së, me fokus të veçantë në fillimin e prodhimit të Llogarive Kombëtare në baza tremujore.

Komponenti 3. Statistikat e Biznesit. Projekti, mes të tjerash, do të punojë me ASK-në në përmirësimin e Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve, prodhimin e indikatorëve afatshkurtër dhe përmirësimin e Regjistrat Statistikor të Bizneseve.

Komponenti 4. TI dhe Diseminimi. Aktivitetet në komponentin 4 janë dizajnuar për të përmirësuar sistemet e TI-së në ASK dhe cilësinë e diseminimit të statistikave nga ASK-ja.

> Kursi mbi statistikën

Në kuadër të komponentit 4, TI dhe Diseminimi, me mbështetjen e dy eksperteve nga Danimarka, ASK-ja ka organizuar një mision, i quajtur Përmirësimi i Diseminimit – Komunikimi i drejtpërdrejtë me përdoruesit. Objektivat konkrete të misionit ishin përgatitja dhe realizimi i një kursi për studentët e Universitetit të Prishtinës. Statistikat e Danimarkës kanë përvojë të mirë me këto lloje kursesh, Studentët e ekonomisë, që morën pjesë në takim, janë përdoruesit kryesorë të ardhshëm të statistikave. Në bashkëpunim me profesororeshën Rahmije Mustafa në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Prishtinës, u diskutua programi dhe më pas u realizua kursi, në dhjetor të vitit 2014. Në sallë kishte mbi 200 studentë të ekonomisë, që ndoqën prezantimet e bëra nga ekspertet e ASK-së dhe ato daneze. Gjatë këtij kursi u prezantuan disa nga burimet e statistikave evropiane, statistikave të Kosovës, mënyra se si të kuptohen statistikat dhe si të përdoren ato. Kursi shkoi shumë mirë dhe u vlerësua mirë. Universiteti është i interesuar të vazhdojë bashkëpunimin, në kuadër të të cilit planifikohet të mbahet edhe një kurs i ngjashëm në vjeshtë të vitit 2015.

> 15 misione gjatë tremujorit të kaluar

Deri tani janë realizuar gjithsej 37 mis-



■ Aktiviteti: Komunikimi i drejtpërdrejtë me përdoruesit



■ Aktiviteti: Komunikimi i drejtpërdrejtë me përdoruesit

ione, 15 nga të cilat gjatë tremujorit të kaluar. Projekti po përparon mirë dhe ka pasur misione në katër komponentet. Për sa i përket zhvillimit të Llogarive Kombëtare në ASK, Projekti i Binjakëzimit ka mbështetur një person nga ASK të marrë pjesë në kursin e Eurostat-it për Llogaritë Kombëtare në kuadër të kornizës së Programit të Trajnimit për Statistikat Evropiane (ESTP). Në nëntor të vitit 2014, 5 persona nga ASK-ja morën pjesë në një vizitë zyrtare për Statistikat e Biznesit në Statistikat e Danimarkës. Gjatë kësaj vizite u trajtuan disa tema, si Regjistri Statistikor i Bizneseve, Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, Metodologjia Statistikore dhe Statistikat Afatshkurta. Gjatë kësaj vizite, partnerët e Binjakëzimit shkëmbyen përvojat e tyre profesionale lidhur me statistikën e biznesit dhe personat nga ASK-ja u njoftuan me procesin e prodhimit të këtyre statistikave në vendet anëtare të BE-së.

Gjatë 12 muajve të kaluar, ekspertë nga Danimarka, Finlanda, Italia dhe Lituanija kanë qenë të përfshirë në projekt dhe tremujori i katërt ka qenë një periudhë shumë e ngarkuar. 32 aktivitetet janë planifikuar për dy tremujorët e ardhshëm – përsëri në katër komponentet.

Per Knudsen Resident Twinning Adviser (RTA)

EU Twinning Project
Support to Statistics in Kosovo
Tel. (RKS) +386 (0)49819307
Tel. (DK) +45 28357071

Project information is available from,
the website

WWW.DST.DK/KOSOVO



This project is funded by the European Union



This project is implemented by Statistics Denmark